



Fuqizimi i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile për të Promovuar Mbrojtjen e Natyrës në Shqipëri



Fuqizimi i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile për të Promovuar Mbrojtjen e Natyrës në Shqipëri

Projekti zbatohet nga:

- ▣ **Drejtues projekti:**
Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri
INCA
<http://www.inca-al.org/>
- ▣ **Partner në zbatimin e projektit:**
Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
IUCN
<https://www.iucn.org/ecaro>
- ▣ **Partneri i asociuar:**
Agjencia Kombëtare e Zonave të Mrojtura
AKZM
<http://akzm.gov.al/>



Fuqizimi i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile për të promovuar mbrojtjen e natyrës në Shqipëri

Për më shumë informacion:
www.inca-al.org/Advocacy

Adresa: Rruga Islam Alla,
Pallati IVEA, Kat I,
Tirana, Albania.
Tel/Fax: +355 42231437
www.inca-al.org
e-mail: info@inca-al.org



This project is funded by the European Union


Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e partnerëve implementues të projektit dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Programi IPA për Shoqërinë Civile dhe Median 2016-2017

Mbështetje për ngritjen e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile

Koncepti

Megjithëse Shqipëria ka një diversitet të lartë biologjik (që përmban rreth 30% të florës evropiane), biodiversiteti po vuan dëme të mëdha në vitet e fundit dhe në shumë raste të pakthyeshme si në rastin e HEC-eve, gurorëve, ndërtimit të infrastrukturës etj., të cilët kanë ndikuar seriozisht në habitatet e specieve të rrezikuara. Shkaqet e korrupsionit në sektorin e mjedisit sidomos në ruajtjen e natyrës dhe përdorimin e qëndrueshëm, përfshijnë shkaqet tipike që i atribuohen çdo sektori tjetër: legjislativi i pamjaftueshëm, mungesa e respektit ndaj ligjit, demokracia e dobët, autoriteti i gjerë që u jepet zyrtarëve publikë, përgjegjësia dhe transparencë minimale, zbatimit të dobët, niveleve të ulëta të profesionalizmit dhe stimujve të mbapshtë.



Në këtë kontekst, projekti **"Fuqizimi i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile për të promovuar mbrojtjen e natyrës në Shqipëri"** synon të përmirësojë menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit, sidomos aseteve natyrore në 4 zona të mbrojtura, duke nxitur një qeverisje pjesëmarrëse dhe transparente duke përfshirë shoqërinë civile mjedisore të mbështetur nga autoritetet publike dhe media.

Projekti ka filluar zyrtarisht më 1 maj 2018 dhe ka një kohëzgjatje prej 36 muajsh. Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA), është udhëheqësi i projektit; Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) është bashkë-partneri në këtë projekt dhe do të ofrojë mbështetje teknike këshillimore për zbatimin e tij. Partneri i asociuar është Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. AKZM do të mbështesë dhe lehtësojë komunikimin e projektit me institucionet publike dhe do të përfitojë nga ngritja e kapaciteteve të këtij projekti për të punuar në nivel rajonal me Agjencitë Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdRZM) në katër zonat pilote.

Objektivat

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të mbështesë punën e advokimit të OMSHC-ve për të promovuar mbrojtjen e mjedisit, luftën kundër korrupsionit në mjedis dhe ndryshimin e klimës, të rrisë të drejtën për informacion mbi procesin e vendimmarrjes që prek mjedisin.

Objektiva specifike:

- Të rrisë dhe fuqizojë aftësitë dhe rolin aktiv të OMSHC-ve për të zbatuar ligjin, për të luftuar korrupsionin dhe për të zvogëluar ndikimet negative në menaxhimin e natyrës dhe menaxhimin e zonës së mbrojtur.
- Të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet OMSHC-ve dhe autoriteteve publike, komuniteteve lokale dhe mediave dhe të nxisë rrjetëzimin dhe ndërtimin e partneritetit mes tyre.



Arritja e katër objektivave do të arrihet nëpërmjet zbatimit me sukses të katër rezultateve të pritura që synojnë:

1. Ndërtimi i kapaciteteve
2. Përmirësimi i kuadrit rregullator
3. Pjesëmarrja aktive
4. Rritja e ndërgjegjësimit

Palët kryesore të interesit dhe grupet e synuara në këtë proces përfshijnë:

- (i) organizatat mjedisore të shoqërisë civile,
- (ii) autoritetet përgjegjëse për ruajtjen e natyrës, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe menaxhimin e ZM-ve në të gjitha nivelet e qeverisjes,
- (iii) sektori privat,
- (iv) komunitetet lokale ku janë vendosur Zonat e Mbrojtura të synuara dhe
- (v) mediat lokale dhe kombëtare.



Skema e Mini grantëve

për OMSHC-të

Programi i Grantëve **"Ndërtimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për advokim dhe pjesëmarrje publike në proceset vendimmarrëse mbi përdorimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore"**



Në kuadër të Projektit, ndërtimi i kapaciteteve të OMSHC-ve nga Shqipëria është planifikuar përmes dhënies së granteve të OMSHC-ve. Rrjedhimisht, OMSHC-të përfituese të përzgjedhura do të rrisin njohuritë, aftësitë dhe kapacitetet e tyre për të zgjeruar angazhimin në aktivitetet e advokimit në nivel kombëtar dhe veçanërisht lokal në zonat pilote të përzgjedhura dhe të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse lidhur me ruajtjen dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura.

OMSHC-të përfituese do të bashkohen një rrjeti kombëtar së bashku me partnerët e projektit, ndërsa do të marrin pjesë aktivisht në aktivitetet kryesore të projektit

Fuqizimi i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile për të Promovuar Mbrojtjen e Natyrës në Shqipëri